



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 905 Prot.

Tiranë, më 28.04.2026

VENDIM QARKULLUES

Nr. 36 Datë 28.04 2026

**“PËR
"PËR MIRATIMIN E NISJES SË PROCEDURAVE PËR HAPJEN E
PROGRAMIT TË PËRBASHKËT “BACHELOR” NË "AKTIVITETE NË
NATYRË (OUTDOOR) DHE TURIZËM SPORTIV", ME DIPLOMË TË
DYFISHTË, MIDIS UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS,
FAKULTETIT TË VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT DHE
UNIVERSITETIT POLITEKNIK SANTAREM, PORTUGALI DHE MIRATIMIN E
MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT”**

Mbështetur në nenin 3, 49 dhe 80 të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në LAL në Republikën e Shqipërisë", Vendimin nr. 57 datë 29.01.2020 "Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës", Udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, në nenin 7, 43, 73 të Statutit të UST-së, në nenin 24 të Rregullores së UST-së, shkresën nr. 824/1 prot., datë 20.04.2026 të Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit "Përcjellje e propozimit për hapjen e programit të dyfishtë "Bachelor" në "Aktivitete në natyrë (outdoor) dhe turizëm sportiv", midis Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe Santarem Polytechnic University Portugalit", në Vendimin e Senatit Akademik nr. 64 dt 21.04.2026, Bordi i Administrimit me Vendim Qarkullues datë 28.04.2026,

V E N D O S I :

1. Miratimin e nisjes së procedurave për hapjen e programit të përbashkët "Bachelor" në "Aktivitete në natyrë (outdoor) dhe turizëm sportiv", me diplomë të dyfishtë, midis Universitetit të Sporteve të Tiranës, Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit dhe Universitetit Politeknik Santarem, Portugalit.
2. Miratimin e Marrëveshjes së programit të përbashkët "Bachelor" në "Aktivitete në natyrë (outdoor) dhe turizëm sportiv", me diplomë të dyfishtë, midis Universitetit të Sporteve të Tiranës, Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit dhe Universitetit Politeknik Santarem, Portugalit.

3. Ky Vendim i përcillet për njohje dhe zbatim FVFR-së, Administratorit dhe Drejtorisë së Zhvillimit Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur ÇOBANI

